**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Adresa:rr.”Adem Jashari” pn, ëëë.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 39.1 pika (k) të Statutit të Komunës së Gjilanit Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më 15.07.2011, miratoi këtë:

# V E N D I M

## I

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit i **PROPOZON** Presidencës së Republikës së Kosovës që: për merita në ruajtjen e substancës etnike shqiptare të Kosovës e të viseve shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia Versajiste dhe Avnojiste, **Mulla Idriz Gjilani** të laureohet me Medaljen më të lartë të Republikës së Kosovës**.**

## II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Propozimi i Kuvendit të Komunës së Gjilanit që Mulla Idriz Gjilani të laureohet me Medaljen më të lartë të Republikës të Kosovës nga Presidenca e Republikës së Kosovës.

## III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesi i KK-Gjilani.

## IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr.__ 16/17856 __
Gjilan më 15.07.2011

Kuvendi i komunës,
__________________
Izmi Zeka, Kryesues